



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë e Huaj C I (Frengjisht)

Ngarkesa: 4 kredite E.C.T.S, seminare 40 orë
Semestri ku zhvillohet : Vtit I/ Semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: “Bachelor në Gjuhë Frënge”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Ky modul, që udhëhiqet nga Kuadri European i Përbashket të Referencave për Gjuhët, u bën të mundur studentëve të zhvillojnë dhe të përftojnë dije lidhur me të vepruarin, të domosdoshme për realizimin me sukses të komunikimit në gjuhën frënge si gjuhë e huaj. Metoda bashkëkohore e përdorur i jep studentit një vend qendror në përvetësimin dhe përdorimin e gjuhës. Tematikat e trajtuara në këtë lëndë kanë si qëllim kryesor të nxisin një interes të vërtetë lidhur me shoqërinë franceze dhe botën frankofone në përgjithësi. Ky modul u bën të mundur studentëve të zhvillojnë dhe përftojnë dije lidhur me elemente të jetës së përditshme si paraqitja, dhënia e informacioneve personale, veprimtaritë e kryera në klasë, studimet, vendet, monumentet, profesionet, pazaret, si dhe elemente kulturore e shoqërore të Francës. Studimi i gramatikës bazohet në një qasje kryesisht të tërthortë dhe synon mësimin nëpërmjet shembullit për të arritur pastaj në konkluzione të përgjithshme. Përparimi në formë spiraleje i lejon jo vetëm marrjen, por edhe përsëritjen e përf forcimin e njohurive të fituara.

Objektivat lëndore:

Mësimi i një gjuhe të huaj të dytë është pjesë e formimit të përgjithshëm të studentëve. Ai është në harmoni të plotë me zbatimin e procesit të Bolonjës, udhëzimet e KE-s mbi shumëllojshmërinë gjuhësore, të niveleve dhe aftësive të përcaktuara në Kuadrin European të përbashkët të referencave për gjuhët si dhe me të drejtën e studentëve për të ndjekur në vitin e parë një gjuhë të huaj të përzgjedhur nga ata vetë.

Mësimi i një gjuhe tjetër të huaj do t'i ndihmojë studentët ta përvetësojnë metodologjinë e të mësuarit të një gjuhe në një këndvështrim tjetër nga ai i gjuhës së huaj të parë për të cilën ata edhe studiojnë. Gjithashtu, ky lloj distancimi do t'i ndihmojë ata ta kuptojnë më mirë funksionimin e secilës gjuhë të huaj në raport me atë amtare. Studenti ka njohuri fare të pakta ose nuk ka aspak njohuri në gjuhën frënge. Pra, ai në këtë modul të parë e zbulon gjuhën dhe merr disa njohuri fillestare për të.